



Plani i Veprimit për Përmirësimin e Cilësisë dhe Reagimit të Sistemit të Aftësimit Profesional (VET) – Në Teori dhe Praktikë



Projekt Nr: 101183369

Çfarë është RAPPORT?

RAPPORT është një projekt Erasmus+ që bashkon partnerë nga Qiproja, Greqia, Italia, Shqipëria dhe Bosnja & Hercegovina për të forcuar sistemet e Aftësimit Profesional (VET) në Ballkanin Perëndimor.

Projekti fokusohet në përmirësimin e cilësisë, inovacionit dhe përputhshmërisë së formimit profesional me tregun e punës, duke ndërtuar bashkëpunim të fortë midis ofruesve të arsimit profesional, bizneseve dhe partnerëve socialë.

Qëllimi

RAPPORT synon të fuqizojë sistemet e aftësimit profesional (VET) që të përgjigjen më mirë nevojave të sotme dhe të së nesërme. Projekti forcon cilësinë dhe inovacionin në trajnim, nxit partneritete të forta mes arsimit dhe industrisë dhe siguron që çdo aftësi të jetë e njohur dhe e vlerësuar. Duke promovuar mësimin gjithëpërfshirës, udhëzimin profesional për të rinjtë dhe integrimin e kompetencave të gjelbra, digjitale dhe sipërmarrëse, RAPPORT kontribuon në një sistem VET modern, të aksesueshëm dhe të orientuar drejt së ardhmes për të gjithë.

Objektivat Kryesore

1. Rritja e kapaciteteve të partnerëve në sigurimin e cilësisë, hartimin e kurrikulave, angazhimin e aktorëve dhe praktikën gjithëpërfshirëse në VET.
2. Zhvillimi i kurrikulave fleksibël dhe të përgjegjshme që përputhen me standardet e kualifikimit, reflektojnë nevojat e tregut të punës dhe integrojnë mësimin në punë dhe validimin e mikro-kredencialeve.
3. Rritja e ekspertizës në e-learning për krijimin e materialeve cilësore për mësim jo-formal.
4. Promovimi i mësimin në vendin e punës duke mbështetur ofruesit e VET në ndërtimin e programeve praktike dhe të orientuara nga tregu.
5. Krijimi i një platforme online për shpërndarjen e burimeve, materialeve të trajnimit dhe praktikeve më të mira.
6. Forcimi i validimit të të nxënies joformal përmes mikro-kredencialeve dhe mjeteve të bazuara në standardin ISO 17024.
7. Përmirësimi i orientimit profesional për të përafuar më mirë aftësitë e të rinjve me mundësitë e punësimit.
8. Nxitja e kompetencave ndërsektoriale — digjitale, të gjelbra dhe sipërmarrëse — përmes kurrikulave të reja dhe mikro-kredencialeve të akredituara.
9. Krijimi i një Komuniteti Praktike për shkëmbimin e përvojave, pilotimin e inovacioneve dhe garantimin e bashkëpunimit afatgjatë rajonal.

Aktivitetet Kryesore

RAPPORT ndërtohet mbi qasjen në tre-faza që kombinon mësimin, praktikën dhe bashkëpunimin:

• Ngritja e Kapaciteteve:

Partnerët marrin pjesë në workshop-e interaktive mbi:

- sigurimin e cilësisë,
- modernizimin e kurrikulave,
- mësimin në punë,
- validimin e aftësive,
- përfshirjen në VET.

• Zbatimi Praktik:

Hartimi i përbashkët i tre kurrikulave modulare — aftësi digjitale, të gjelbra dhe sipërmarrëse — të zhvilluara përmes një platforme online asinkrone/jo formale dhe të orientuara nga tregu i punës.

• Komuniteti i Praktikës:

Krijimi i një rrjeti transnacional të profesionistëve të VET për shkëmbim përvojash, praktika të mira dhe inovacion të vazhdueshëm në trajnim profesional.




Rezultatet Kryesore të Projektit

- Toolkit për Ngritjen e Kapaciteteve – paketë gjithëpërfshirëse burimesh mbi sigurimin e cilësisë, hartimin e kurrikulave, validimin e aftësive dhe përfshirjen.
- Tre Kurrikula Ndërsektoriale – module mbi aftësitë digjitale, të gjelbra dhe sipërmarëse, të përafruara me kornizat e BE (DigComp, GreenComp, EntreComp).
- Platforma Online e Mësimit – hapësirë digjitale për trajnime asinkrone, e aksesueshme për të gjithë nxënësit dhe mësuesit.
- Sistemi i Mikro-kredencialeve – mjete për njohjen e të nxënit joformal dhe certifikimin e aftësive sipas standardit ISO 17024.
- Komuniteti i Praktikës – një rrjet i qëndrueshëm për shkëmbimin e njohurive, praktikave të mira dhe ideve inovative.

Inovacioni i Projektit

RAPPORT prezanton një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt praktikës për përmirësimin e VET përmes:

- Modelit tre-nivelësh “nga teoria në praktikë” që kombinon trajnimin, bashkë-krijimin dhe bashkëpunimin.
- Integrit të kornizave të kompetencave të BE-së (EntreComp, DigComp, GreenComp) në sistemet kombëtare.
- Përdorimit të mikro-kredencialeve për njohjen fleksibël dhe ndërkufitare të të nxënit.
- Qasjes sistemike që lidh sigurimin e cilësisë, modernizimin dhe përfshirjen.
- Modelit të qëndrueshëm të partneritetit që lidh ofruesit e VET, dhomat e tregtisë dhe industrinë për një ndikim afatgjatë.



Koordinatori:

MMC Mediterranean
Management Centre

Contact Us:

Address: 16, Imvrou Street, 1055 Nicosia, Cyprus

Tel. No: +357 22466633

E-mail: europeanprojects@mmclearningsolutions.com

Website: www.mmclearningsolutions.com

Partnerët:



**Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian**

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti finansues nuk mund të mbahen përgjegjës për to.